



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1569/1 Prot.

Tiranë, më 15 / 10 / 2019

V E N D I M

Nr. 144 , Datë 15 / 10 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 88, datë 24.07.2019, të bërë nga H.XH kundër Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe Zyrës Vendore Arsimore Bulqizë (ZVA Bulqizë), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”, “gjendjes shëndetësore¹” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Me Vendimin nr. 11, datë 05.02.2008 është emëruar si specialiste Finance pranë Zyrës Arsimore Bulqizë. Me shkresën nr. 3560/3, datë 28.03.2019 “Njoftim mbi fillimin e procedurës së ristrukturimit/mbylljes së ZA Bulqizë”, është njoftuar për fillimin e procesit të ristrukturimit të DAR-eve dhe ZA-ve në kuadër të krijimit të DPAP. Në datë 20.05.2019, nga Përgjegjësi i ZVA Bulqizë, i është komunikuar lirimi nga shërbimi civil. DPAP ka nxjerrë urdhrin për konfirmimin në punë të të gjithë punonjësve ekzistues në ZVA Bulqizë dhe në pozicionin e punës që ankuesja mbante, ka urdhëruar vijimin e punës për punonjës P.L, pozicioni i punës i të cilit ishte shkurtuar. Ankuesja shprehet se është ndjerë e shqetësuar dhe e tronditur nga fakti që për*

¹ Referuar Vërtetimit datë 06.06.2019 të Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, H.Xh ka qenë e shtruar nga data 28.10.2015 deri në datë 04.11.2015.

pozicionin e punës që ajo mbante është preferuar një burrë, pa marrë parasysh dhe faktin që ajo ka probleme shëndetësore, pasi në vitin 2015 është operuar dy herë në Spitalin Onkologjik Tiranë, dhe vazhdon mjekimet e kontrollet e përsëritura. Pas marrjes së njoftimit për largim nga puna i është drejtuar me ankesë DPAP. Ankesa i është marrë në shqyrtim nga DPAP dhe si rezultat në datë 30.05.2019 i është ofruar punë si Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve në ZVA Dibër, pa e konsultuar, pa marrë parasysh gjendjen e saj shëndetësore si dhe faktin që distanca mes qyteteve Peshkopi-Bulqizë është 45 km. Në datë 05.06.2019 është paraqitur pranë ZVA Dibër dhe më pas ka njoftuar DPAP, që për shkak të largësisë dhe gjendjes shëndetësore nuk mund të vazhonte punë, dhe që nga ai moment vijon të jetë e papunë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 88, datë 24.07.2019 të H.XH u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1152/1, datë 31.07.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga MASR, DPAP dhe ZAV Bulqizë për ankesën e bërë nga H.XH si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të procedurës së emërimit dhe largimit nga detyra të punonjësve, H.XH dhe P.L.
 - Kopje të strukturës dhe organikës së vjetër të ZA Bulqizë.
 - Kopje të strukturës dhe organikës së re të ZVA Bulqizë.
 - Kopje të përshkrimit të punës, kritereve të përgjithshme dhe të posaçme, për pozicionin e punës, Specialist i Financës në ZA Bulqizë (sipas strukturës së vjetër).
 - Kopje të përshkrimit të punës, kritereve të përgjithshme dhe të posaçme, për pozicionin e punës, Specialist i Financës në ZVA Bulqizë (sipas strukturës së re).
 - Kopje të procesit të vlerësimit dhe pikëzimit për punonjësit, H.XH dhe P.L.
 - Kopje të Vendimit nr. 4980/190, datë 08.05.2019 të Komisionit të Ristrukturimit.
 - Kopje të vlerësimit të punës për vitet 2017 dhe 2018 për punonjësit H.XH dhe P.L.

Me shkresën nr. 318/1, datë 06.08.2019, ZVA Bulqizë në mes të tjerash informoi se: *“Njoftimi për fillimin e procedurës së ristrukturimit/mbylljes së ZA Bulqizë i ka vajtur të gjithë punonjësve sipas strukturës, që kanë qenë në marrëdhënie pune. DPAP ka nxjerrë “Urdhër për emërim të përkohshëm në detyrë” për 5 (pesë) punonjës sipas emrit të ri të pozicionit të punës, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune, nga 6 (gjashtë) punonjës që ishin gjithsej. Nuk është konfirmuar në pozicionin e tij të punës A.H si specialist në Sektorin e TIK dhe Bazës Statistikore, pasi ky sektor nuk është në organikën e ZVA-së”.*

Me shkresën nr. 2101, datë 09.08.2019, DPAP në mes të tjerash informoi se: *“H.XH ka qenë e punësuar pranë ZA Bulqizë (sot ZVA Bulqizë), për periudhën nga data 16.01.2008 deri në datë 31.05.2019, dhe ka mbajtur pozicionin, Specialist Finance në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në ZA Bulqizë. Me shkresën nr. 3560/3, datë 28.03.2019 të MASR “Njoftim mbi fillimin e procedurës së ristrukturimit/mbylljes së ZA Bulqizë”, H.XH është njoftuar se bazuar në Vendimin nr. 99, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të DPAP”, DAR-et dhe ZA-të do të riorganizohen në kuadër të DPAP dhe se bazuar në legjislacionin për shërbimin civil do të jetë objekt i gjykimit për transferimin ose përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil. Me urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019, të MASR, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”, është përcaktuar struktura e ZVA-ve dhe organika e tyre sipas 4 Drejtorive Arsimore Rajonale. Sipas këtij urdhri, numri i punonjësve të ZVA-ve do të ishte 428 vetë. Sipas VKM-së 99/2019, marrëdhënia e punës për punonjësit e ZVA-ve nuk rregullohet më*

nga legjislacioni i shërbimit civil, pasi këto institucione nuk bëjnë më pjesë në fushën e veprimit të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, pasi sipas VKM-së 99/2019, ato janë organizuar si njësi të ofrimit të shërbimit, në varësi të DPAP dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të këtyre strukturave të reja do të rregullohen sipas Kodit të Punës. Sipas Vendimit nr. 4980, datë 08.05.2019 “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civil të DAR dhe ZA” të Komisionit të Ristrukturimit të ngritur në MASR, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për 344 punonjës të ish-DAR/ZA. Në këto kushte H.XH, si dhe të gjithë punonjësit e DAR/ZA-ve, u liruan nga Shërbimi Civil, pasi pozicionet e punës që ato mbanin nuk do të ishin më pjesë e Shërbimit Civil. Referuar Urdhrit nr. 349, datë 30.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” të DPAP, H.XH është emëruar Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune. H.XH në datë 05.06.2019 ka dërguar email ku shprehimisht citohet se: “Ju falenderoj për këtë emërim, por nuk mund të vazhdoj në këtë detyrë për arsye të largësisë së rrugës dhe arsye familjare”. Në bazë të dorëheqjes nga detyra, H.XH me Vendimin nr. 101, datë 06.06.2019 i është bërë dhe miratimi i dorëheqjes. DPAP nuk mund të marrë vendim për rikonfirmimin e H.XH si specialiste pranë ZVA Bulqizë pasi nuk mund të flitet për rikonfirmim në detyrë të ankueses për sa kohë që ajo është liruar nga shërbimi civil. Bazuar në pikën 13 të VKM 99/2019 pretendimi i ankueses është i pabazuar pasi pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve të ZVA-ve bëhet mëpërmjet procedurave të konkurimit, i cili nuk është shpallur ende. Në këto kushte ankuesja ka gjithë të drejtën që të aplikojë dhe të konkurojë për këtë pozicion ose çdo pozicion tjetër sipas strukturës së miratuar. DPAP në procesin e sistemimit të punonjësve të ZVA-ve, në rastet kur ka pasur më shumë se një kandidat për një vend pune, ka mbajtur parasysh disa kriteret si më poshtë: 1. Përputhshmëria e diplomës me vendin e punës. 2. Vjetërsia në profesion. 3. Vjetërsia në të njëjtin pozicion në institucionin që rristrukturohet. 4. Kualifikimet e secilit punonjës. 5. Vlerësimi i punës. Nga analiza e këtyre elementëve rezulton se në pikat 1, 4, 5, H.XH dhe P.L kanë vlerësim të njëjtë, ndërkohe sa i takon vjetërsisë në punë dhe vjetërsisë në të njëjtin pozicion, P.L ka më shumë përvojë. Në interpretim të pikave të mësipërme DPAP ka emëruar P.L në pozicionin e specialistit të financës deri në përfundim të procedurave të konkurimit për arsye të vjetërsisë më të madhe në punë dhe në ZVA Bulqizë dhe për arsye se ka mbuluar marrëdhëniet me thesarin. H.XH ka depozituar pranë DPAP një kërkesë për trajtim të rastit të saj. DPAP menjëherë pasi ka evidentuar rastin e daljes në pension të një punonjësi të profilin financiar, ka bërë emërimin me kontratë të H.XH në pozicionin e Përgjegjës së Sektorit të Shërbimeve në ZVA Dibër. Kjo detyrë është refuzuar nga ankuesja me arsyetimin e pamundësisë së ndjekjes së detyrës për shkak të largësisë. Sa i takon pretendimit të ankueses për gjendjen shëndetësore duke mos paragjykuar gjendjen e H.XH, sqarohet se në DPAP nuk është administruar asnjë informacion nga ankuesja në lidhje me gjendjen e saj shëndetësore”.

- Me shkresën nr. 1152/4, datë 26.08.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga MASR dhe DPAP, dokumentacion shtesë.

Me shkresën nr. 7699/2, datë 28.08.2019, MASR në mes të tjerash informoi se: “Në zbatim të Vendimit nr. 99, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e

organizimit dhe të funksionimit të DPAP” është krijuar DPAP, institucion i cili përfshin tërësinë e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të MASR, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor. VKM nr. 66, datë 03.02.2010 “Për riorganizimin e DAR/ZA-ve”, i ndryshuar, është shfuqizuar. Në këtë kuptim përfundojnë marrëdhëniet juridike të punës së nëpunësve të DAR/ZA-ve në shërbimin civil. Në pikën 6, të nenit 50, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, parashikohet se përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, lejohet vetëm në rastin kur si pasojë e këtyre procedurave, ka shkurtim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë. Sqarohet se si pasojë e mbylljes së DAR/ZA-ve, ka një shkurtim të numrit të përgjithshëm prej 496 nëpunësish civilë. Bazuar në Kreun III, pika 14 të VKM nr. 99/2019 emërimet dhe lirimet e punonjësve të DRAP dhe ZVAP, bëhen nga DPAP. Sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, emërimet dhe lirimet janë akte administrative të pavarura të DPAP-së, të cilat fillojnë një marrëdhënie pune të re ndërmjet palëve”.

Me shkresën nr. 2233, datë 03.09.2019, DPAP informoi Komisionerin se: *“Procesi i vlerësimit dhe pikëzimit të punonjësve është bërë duke analizuar dosjet e punonjësve, në rastet kur ka pasur më shumë se një kandidat për një vend pune. Për rastin e H.Xh dhe P.L në krahasimin e të dhënave të tyre janë mbajtur parasysh elementët e mëposhtëm:*

Nr.	Përshkrimi	P.L	H.Xh
1.	Vjetërsia në punë në profesion	1982 – 2019	1991 – 2019
2.	Vjetërsia në ZA Bulqizë	2001 – 2019	2008 – 2019
3.	Vlerësimi i titullarit	Mirë	Mirë

Nga analiza e elementëve të mësipërm rezulton se H.Xh dhe P.L kanë vlerësim të njëjtë pune, ndërkohë sa i takon vjetërsisë në punë dhe vjetërsisë në të njëjtin pozicion, P.L ka më shumë përvojë dhe për këtë arsye është përzgjedhur, P.L. Në bazë të VKM nr. 99/2019 emërimi i P.L është deri në përfundim të procedurave të konkurimit”.

- Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 165, datë 16.09.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në MASR”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë MASR në datë 24.09.2019, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-s, morën takim me A.K, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Ekonomike dhe Sh.A me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, pranë MASR.

Gjatë inspektimit A.K informoi se ristrukturimi i DAR/ZA-ve ka prekur një numër të madh punonjësish. Ky ristrukturim ka prekur në numrin më të madh punonjësit me profil shkenca ekonomike. H.XH i është ofruar punësimi në DRA Dibër dhe ka mundësi që të konkurojë në konkursin që do zhvillohet për vendin e punës të specialistit të financës në ZVA Bulqizë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

H.XH me Vendimin nr. 11, datë 05.02.2008 është emëruar si Specialiste Finance pranë Zyrës Arsimore Bulqizë dhe marrëdhëniet financiare i kanë filluar që në datë 16.01.2008. Me shkresën nr. 3560/3, datë 28.03.2019 të MASR “*Njoftim mbi fillimin e procedurës së ristrukturimit/mbylljes së ZA Bulqizë*”, H.XH është njoftuar se bazuar në Vendimin nr. 99, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të DPAP*” DAR-et dhe ZA-të do të riorganizohen në kuadër të DPAP, dhe se bazuar në legjislacionin për shërbimin civil, ajo do të jetë objekt i gjykimit për transferimin ose përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil. Komisioni i Ristrukturimit i MASR me shkresën nr. 4980/190, datë 08.05.2019 ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për H.XH në pozicionin Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në ZA Bulqizë. Me shkresën nr. 5145/5, datë 14.05.2019 të MASR, “Vendim për lirim nga shërbimi civil”, H.XH, me detyrë Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, është njoftuar për lirim nga shërbimi civil.

Pas marrjes së njoftimit për largim nga puna, H.XH i është drejtuar me ankesë DPAP. DPAP me Urdhrin nr. 349, datë 30.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” ka emëruar H.XH në pozicionin si, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune. H.XH me email-in datë 05.06.2019 ka njoftuar, se për arsye të largësisë së rrugës dhe arsye familjare nuk mund të vazhonte më punë pranë ZVA Dibër. DPAP me Vendimin nr. 101, datë 06.06.2019 ka bërë miratimin e dorëheqjes së H.XH dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Referuar ndryshimeve strukturore dhe riorganizimit të DAR/ZA-ve në kuadër të krijimit të DPAP, rezulton se:

- Me Urdhrin nr. 199, datë 01.12.2010 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DAR dhe ZA*” është miratuar struktura dhe organika e DAR-eve dhe ZA-ve dhe numri gjithsej, 509 veta. Referuar këtij urdhri ZA Bulqizë përbëhej nga 10 punonjës, dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse përbëhej nga 4 punonjës: 1 Përgjegjës Sektori dhe 3 Specialist.
- Me Vendimin nr. 99, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të DPAP*” është krijuar DPAP, institucion i cili përfshin tërësinë e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor.

- Me Urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019, të MASR, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”, është përcaktuar struktura e ZVA-ve dhe organika e tyre sipas 4 Drejtorive Arsimore Rajonale. Sipas këtij urdhri, numri i punonjësve të ZVA-ve do të ishte 428 vetë. Referuar këtij urdhëri ZVA Bulqizë do të kishte gjithsej 6 punonjës, dhe Sektori i Shërbimeve do të përbëhej nga 2 punonjës: Specialist i Financës dhe Specialist Jurist.
- Referuar pikës 13, Kreu III, të VKM-së nr. 99/2019 përcaktohet se: “Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëpunësve të DPAP-së, në nivel qendror dhe rajonal, si dhe në njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit të hapur, mbi bazën e rregullave të miratuara me urdhër të ministrit”.
- Komisioni i Ristrukturimit i MASR me shkresën nr. 4980, datë 08.05.2019 “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civil të DAR dhe ZA” ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për 344 punonjës të ish DAR/ZA-ve.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, lidhur me ristrukturimin e DAR/ZA-ve, rezulton se të gjithë punonjësit që kanë punuar pranë këtyre strukturave, bazuar në procedurat e parashikuara në nenin 50 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, dhe VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, janë njoftuar për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil dhe për të gjithë punonjësit e këtyre strukturave, nga ana e MASR, janë ndjekur të njëjtat procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë ankuesen dhe P.L.

Referuar strukturës dhe organikës së ZVA Bulqizë, rezulton se struktura e ZA Bulqizë përbëhej nga 10 punonjës dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse përbëhej nga 4 punonjës, ndërsa me strukturën e re, ZVA Bulqizë do të përbëhej nga 6 punonjës, dhe Sektori i Shërbimeve do të përbëhej nga 2 punonjës. Pra rezulton që sektori ku punonte ankuesja do reduktohej me dy pozicione pune. Referuar strukturës së vjetër në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse ishin të punësuar dy punonjës me profilin ekonomist, H.XH në pozicionin si specialiste page dhe P.L në pozicionin si specialist buxheti³, në këto kushte për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të ZVA Bulqizë, DPAP si institucion i krijuar për sigurimin e ofrimit të shërbimeve arsimore parauniversitare, kishte detyrimin për përzgjedhjen e një punonjësi që të mbulonte pozicionin e specialistit të financës në ZVA Bulqizë.

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, në analizë të kriterëve të përcaktuara si: 1. Përputhshmëria e diplomës me vendin e punës. 2. Vjetërsia në profesion. 3. Vjetërsia në të njëjtin pozicion në institucionin që ristrukturohet. 4. Kualifikimet e secilit punonjës. 5. Vlerësimi i punës, me Urdhrin nr. 131, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” ka

³ Referuar strukturës së pagesave për punonjësit për vitin shkollor 2018-2019 të dërguar nga ZVA Bulqizë në datë 06.08.2019.

përzgjedhur për të emëruar në detyrën si Specialist Finance deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune, P.L.

Referuar kritereve të sipërcituara, rezulton se P.L ka më shumë vite pune në ushtrim të profesionit dhe të vjetërsisë në të njëjtin pozicion pune, për më tepër që P.L, për një periudhë kohe ka ushtruar dhe detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse⁴.

Komisioneri vlerëson se punonjësi P.L për shkak të vjetërsisë në profesion dhe në vendin e punës është vlerësuar nga ana e DPAP, se i plotëson më mirë kriteret se ankuesja dhe përvoja e punës e P.L ka qenë elementi që ka prevaluar në emërimin e tij të përkohshëm në pozicionin si Specialist Finance pranë ZVA Bulqizë.

Pra, vetë ankuesja nuk është në kushtet e plotësimit të barabartë të kritereve të vendosura nga DPAP, që të mund të merrej në konsideratë, për efekt krahasimor elementi “gjinia” dhe “gjendja shëndetësore”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

⁴ Referuar Vendimit nr. 26, datë 09.05.2017 “Për emërim në detyrë”.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk ka tagër të gjykojë mbi nevojat apo procesin e ritrukturimit të një institucioni si MASR, por mbështetur në atributet që i jep Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mund të kryejë konstatim, nëse ankuesja i është nënshtruar apo ekspozuar një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues apo të pabarabartë, nga ana e MASR, DPAP dhe ZVA Bulqizë, në krahasim me punonjës të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në kuptim të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.

Mbështetur në analizimin e fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e trajtimit të pabarabartë të ankuesit, në krahasim me punonjës të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme, me të, nga ana e MASR, DPAP dhe ZVA Bulqizë.

Për sa më sipër, në mungesë të trajtimit të pabarabartë të ankuesit nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkakun e pretenduar nga H.XH, nga ana e MASR, DPAP dhe ZVA Bulqizë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases H.XH nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrës Vendore Arsimore Bulqizë për shkak të gjinisë dhe gjendjes shëndetësore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONER